

Energji Ashta Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	7
Pasqyra e flukseve monetare	8
Shënime të pasqyrave financiare	9-34



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe Aksionarët e Energji Ashta sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Energji Ashta sh.p.k (më poshtë “Shoqëria”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 9 deri në faqen 34.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Energji Ashta sh.p.k paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Nderkombetare të Kontabilitetit (SNK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) bashkë me kërkesat e etikës që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri material ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të


modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijëmbës.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

TPA Albania Shpk

Date 27.03.2025



Laura Gjinali
Auditues Ligjor



TPA Albania shpk

Rr.Ibrahim Rugova, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Energji Ashta Sh.p.k.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivet			
Aktive afatgjata materiale	7	22,063,370	20,032,305
Aktive afatgjata jo materiale	8	14,604,627,039	15,380,458,833
Detyrimi për tatimin e shtyrë		545,751,628	574,674,861
Totali i aktiveve afatgjata		15,172,442,037	15,975,165,999
Inventari	9	120,540,493	119,622,712
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	10	5,991,239	6,946,975
Llogari të arkëtueshme	11	282,778,530	521,614,149
Aktive të tjera	12	2,007,145,202	1,641,362,115
Depozita e mjete monetare të kufizuara	13	5,168,539	3,010,750
Mjetet monetare	14	176,336,584	6,080,221
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,597,960,587	2,298,636,922
Totali i aktiveve		17,770,402,624	18,273,802,921
Kapitali			
Kapitali aksionar	15	12,460,176,500	12,460,176,500
Humbje të akumuluar		(2,798,805,448)	(4,229,847,937)
Fitimi/humbja për periudhën		756,772,440	1,431,042,489
Totali i kapitalit		10,418,143,492	9,661,371,052
Detyrimet			
Hua afatgjata	16	6,502,437,500	7,609,210,000
Totali i detyrimeve afatgjata		6,502,437,500	7,609,210,000
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	16	708,424,746	751,622,616
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	17	141,396,886	251,599,253
Totali i detyrimeve afatshkurtra		849,821,632	1,003,221,869
Totali i detyrimeve		7,352,259,132	8,612,431,869
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		17,770,402,624	18,273,802,921

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet në vijim.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Energji Ashta Sh.p.k. më 27 Mars 2025 dhe nënshkruar nga:


Peter Stelzer
Administrator


Peter Loidl
Administrator


HM&H BUSINESS Sh.p.k
NUIŠ: L31615002K
Brunila Leskaj
Rr. Abdi Toptani, Nd. Torre Drin, Kati 4
Tirane, Shqipëri
Kontabel i Vlerave
HM&H Business Sh.p.k

Energji Ashta Sh.p.k.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Të ardhura	18	1,790,177,455	2,275,124,640
Të ardhura të tjera		523,376	58,185
Blerje mallra dhe shërbime të tjera		(39,439,293)	(49,416,648)
Kosto personeli	19	(58,693,505)	(55,232,204)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7, 8	(781,003,094)	(780,898,854)
Shpenzime të tjera operative	20	(120,435,572)	(121,575,885)
Rezultati nga veprimtaria operative		791,129,367	1,268,059,234
Të ardhura nga interesi		58,254,046	35,065,770
Interesi dhe shpenzime të tjera	21	(280,537,099)	(331,991,318)
Fitimi/(humbja) neto nga kurset e këmbimit	22	322,594,044	712,566,531
Kosto financiare neto		100,310,991	415,640,983
Fitimi/(humbja) e vitit para tatimit		891,440,358	1,683,700,217
Shpenzimet e tatimit fitimit	23	(105,744,165)	(223,707,045)
Shpenzime (benefite) nga aktivet tatimore të shtyra		(28,923,753)	(28,950,683)
Humbja për periudhën		756,772,440	1,431,042,489
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën		756,772,440	1,431,042,489

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet në vijim.

Energji Ashta Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 1 Janar 2023	12,460,176,500	(4,229,847,937)	8,230,328,563
Humbja e vitit	-	1,431,042,489	1,431,042,489
Kontribute nga ortakët	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	12,460,176,500	(2,798,805,448)	9,661,371,052
Fitimi i vitit	-	756,772,440	756,772,440
Kontribute nga ortakët	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	12,460,176,500	(2,042,033,008)	10,418,143,492

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet në vijim.

Energji Ashta Sh.p.k.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	2024	2023
Fluksi nga veprimtaritë operative		
Fitimi/(humbja) para tatimit	891,440,358	1,683,700,217
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi (7,8)	781,003,094	780,898,854
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	-	191,371
Shpenzime interesi	280,537,099	331,991,318
Të ardhura nga interesi	-	-
	1,952,980,551	2,796,781,760
<i>Ndryshime në:</i>		
Parapagime, të arkëtueshme, aktive të tjera	(125,991,733)	(709,968,268)
Depozita e mjeteve monetare të kufizuara	(2,157,789)	20,418,539
Inventar	(917,779)	(5,871,200)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	-	-
Te pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera	(110,202,888)	38,489,594
	1,713,710,362	2,139,850,424
Mjete monetare nga veprimtaritë operative		
Tatim fitimi i paguar	(105,744,165)	(223,707,045)
Interes i paguar	(280,537,099)	(331,991,318)
Te ardhura nga interesi	-	-
	1,327,429,098	1,584,152,061
Mjete monetare (përdorur)/nga veprimtari operative		
	1,327,429,098	1,584,152,061
Fluks nga veprimtari investuese		
Blerje e aktiveve të tjera të materiale	(7,202,365)	(124,178)
Blerje e aktiveve të tjera të jo-materiale	-	-
	(7,202,365)	(124,178)
Mjetet monetare përdorur në veprimtari investuese		
	(7,202,365)	(124,178)
Fluks nga veprimtari financuese		
Te ardhurat neto/(pagesat e) të huasë	(1,149,970,370)	(1,634,596,403)
Rritje e kapitalit aksionar	-	-
	(1,149,970,370)	(1,634,596,403)
Mjetet monetare neto nga/(përdorur) ne veprimtari financuese		
	(1,149,970,370)	(1,634,596,403)
Rritja neto/(ulja) e mjeteve monetare dhe ekuivalente	170,256,363	(50,568,520)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	6,080,221	56,648,741
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor (shënimi 12)	176,336,584	6,080,221

Pasqyra flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet në vijim.

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqëria") është regjistruar në 11 dhjetor 2008. Zyra qendrore e shoqërisë është e vendosur në Shkoder, Shqipëri.

Marrëveshja e koncesionit

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1363, datë 22 tetor 2008 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts-Aktiengesellschaft, për ndërtimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit për Hidrocentralin e ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë", Qeveria Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ("METE") dhe Shoqëria hynë në një Marrëveshje Koncesioni, datë 17 tetor 2008 ("Marrëveshja e Koncesionit").

Objektivi kryesor i Shoqërisë është zbatimi i Marrëveshjes së Koncesionit. Koncesioni jepet për një periudhë 35 vjeçare, duke filluar nga 17 tetori 2008. Bazuar në Marrëveshjen e Koncesionit Shoqërisë i caktohen si më poshtë:

- (i) projektimi, financimi, ndërtimi, testimi, zotërimi, veprimtaria dhe mirëmbajtja e hidrocentralit;
- (ii) pasurimi dhe rinovimi i objekteve ekzistuese, të zotërojë pjesët e pasuruara dhe të rinovuar të objekteve ekzistuese sipas kërkesave ligjore dhe të përdore dhe mirëmbajë objektet ekzistuese;
- (iii) të gëzojë uzufuktet;
- (iv) të ketë të drejtë përdorimi të ujit në nivelin më të ulët të lumit Drin (brenda zonës së koncesionit);
- (v) të furnizojë KESH me prodhim të përkohshëm dhe me prodhim neto të energjisë elektrike dhe të mbledhë pagesat e blerësve në përputhje me kohën dhe kushtet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe t'i shesë palëve të treta prodhimin neto të energjisë elektrike në një treg të hapur;
- (vi) t'i rikthejë Qeverisë Shqiptare përdorimin e zonës së koncesionit dhe të drejtën për transferim, dhe t'i transferojë Qeverisë Shqiptare pronësinë e hidrocentralit dhe objekteve ekzistuese me përfundimin e periudhës së koncesionit;
- (vii) të ketë të drejtën ekskluzive mbi çdo atribut mjedisor të lindur nga projekti, duke përfshirë edhe certifikimet që lidhen me të.

Marrëveshja e koncesionit përmban një mundësi rinovimi.

Bazuar në marrëveshjen 'Off-Take' me KESH Sh.a. ("KESH") më datë 30 shtator 2008, Shoqëria i faturon OSHEE sasinë e deklaruar me cmimin e përcaktuar.

Bazuar në Marrëveshjen e datës 13.07.2017 të nënshkruar midis Autoritetit Kontraktues dhe Energji Ashta, Marrëveshja e Koncesionit u ndryshua për të pasqyruar transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas marrëveshjes e 'Off-Take' nga KESH tek grupi i OSHEE; ndryshimi i Marrëveshjes së Koncesionit u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 18.01.2017.

Për shkak të ndryshimeve në sektorin Shqiptar të energjisë elektrike, OSHEE GROUP dhe FTL rane dakord me Energji Ashta si shites që të transferojnë të drejtat dhe detyrimet e Blerësit sipas marrëveshjes së 'Off-Take' nga OSHEE GROUP tek FTL duke filluar nga data 1 Janar 2020.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM (VAZHDIM)

Marrëveshja e grupit të balancimit.

Bazuar ne Marrëveshjen e dates 25.03.2021 te nenshkruar ndermjet KESH-it dhe EA. KESH do te perfshije EA ne grupin balancues te energjise KESH dhe do te balancoje se bashku rrjedhen e energjise.Tarifa per kete sherbim llogaritet ne baze te tregut.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të cilat janë baza për raportimin financiar ligjor të Shoqërisë.

Shoqëria mban regjistrat e saj te kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare ne perputhje me Ligjin e Kontabilitetit Nr. 25/2018 date 10 maj 2018 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” qe hyri ne fuqi me 1 Janar 2019.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njera tjetres dhe shuma neto raportohet ne pasqyren e pozicionit financiar vetem kur ekziston nje e drejte ligjesisht e zbatueshme per te netuar shumat e njohura dhe ka qellim shlyerjete tyre mbi baze neto, ose te realizoje aktivet dhe te shlyeje detyrimet ne te njejten kohe. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve, pervec nese kerkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sic parashikohet ne menyre specifike ne politikat kontabel te Shoqerise.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi baza të kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është dhe monedha funksionale dhe e prezantimit për Shoqërinë.

(d) Vlerësimi i menaxhimit mbi vijimësinë e aktivitetit

Më 31 Dhjetor 2024, Shoqëria ka humbje të akumuluar (2,042,033,008) Lek (2023: 2,798,805,448Lek), te cilat i atribuohen se shumti fazes se investimit. Gjatë vitit 2013, Shoqëria ka përfunduar fazën e investimit dhe të ndërtimit dhe ka filluar prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.

Drejtimi beson që Shoqëria do të jetë në gjendje të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë nuk do të dëmtohet. Për këtë arsye, Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit te vijimësisë.

(e) Standarde të reja, interpretime dhe ndryshime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2024:

— SNRF 16 Qiraja: Detyrimet e Qerases Financiare ne shitje dhe ridhenie me qera ,(i vlefshëm për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2024 dhe pas tij),

— SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i detyrimeve aftshkurter/afatgjate (i vlefshëm për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2024 dhe pas tij),

— SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Zbulimet për Instrumentet Financiare - Marrëveshja Financiare e Furnizuesit (i vlefshëm për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2024 dhe pas tij).

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(f) Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive

Një sërë standardesh të reja janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2024 dhe aplikimi i hershëm i tyre është i lejuar; Standardet e ndryshuara dhe interpretimet e mëposhtme nuk pritët të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

— SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Mungese në Shkembueshmerine (ndryshime). Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2025, me aplikimin e mëparshëm të lejuar.

— SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Marreveshja Financiare e Furnizuesit (ndryshime). Në maj 2024, BSNK lëshoi amendamente që hyjnë në fuqi më 1 janar 2026, me aplikimin e mëparshëm të lejuar.

— SNRF 18 Prezantimi dhe Shenimet shpjeguese në Pasqyrat Financiare / SNRF 19 SNRF 19 Filialet pa shenimet shpjeguese të Përgjegjësisë Publike. Në fuqi më 01 janar 2027.

— Ndryshime të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Sipërmarrjet e Përbashkëta – Shitja ose dhurimi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij apo sipërmarrjes së përbashkët (i disponueshëm për aplikim/datë efektive shtyrë për një kohë të pacaktuar).

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

3. GJYKIME DHE VLERESIME TE RENDESISHME KONTABËL

Në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë, që përkruhen në Shenimin nr 4, drejtimit i kërkohet të bëjë gjykime, cmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në cmuarjet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën cmuarja është rishikuar nëqoftëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme nëqoftëse rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga cdo njësi gjeneruese e parasë dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon rregullisht jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson nëse jeta e përcaktuar si e dobishme e aktiveve, përfaqëson dobishmërinë e pritur të aktiveve. Vlerat kontabël e këtyre aktiveve analizohet në Shenimin 7 dhe 8. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërimit teknologjik dhe faktorëve të tjerë.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe për llogaritë e tjera të arkëtueshme bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e kërkuara. Vlerësimi është bazuar në vjetërimin (aging) e gjendjes së llogarive të arkëtueshme dhe përvojën historike të shlyerjes, kreditin e konsumatoreve dhe ndryshimeve në aspektin e pagesave të konsumatoreve gjatë vlerësimit të humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Këto përfshijnë supozime mbi sjelljen e konsumatorëve dhe mbledhjen e mjeteve monetare të ardhshme që rezultojnë prej saj. Nëse gjendja financiare e klientëve do të përkeqësohej, zhvlerësimi aktual i llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jetë më i lartë se sa pritët dhe mund të tejkalojë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani.

Inventaret

Inventaret fillimisht rregjistrohen me kosto, që përbëhet nga cmimi i blerjes duke shtuar dhe kostot e drejtperdrejta si transport dhe parking, akcize, kosto e analizës së cilësisë të mallit të importit dhe taksat e agjensisë doganore.

Inventari me pas paraqitet me vlerën me të ulet mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kur përcakton vlerën neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh provat me objektive të dhënat në dispozicion të marra gjatë kryerjes së vlerësimeve.

Vlera neto e realizueshme është e vlerësuar me cmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus shpenzimet e nevojshme për të bërë produktin gati për t'u shitur.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë të konvertuara në lekë dhe regjistrohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet monetare dhe zëra të tjerë jo monetare në monedhë të huaj rivlerësohen në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës raportuese. Diferencat e këmbimit valutor janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të Shoqërisë. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për perktimin e zerave të pozicionit financiar të shprehur në monedhe të huaj paraqiten si vijon (në Lekë):

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
1 EUR	98.15	103.88

(b) Aktivet jo-materiale

(i) Marrëveshjet e Koncesionit

Shoqëria njih një aktiv jo-material që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare shërbimesh, kur ajo ka të drejtën për të shitur energjinë elektrike të prodhuar nga infrastruktura e koncesionit. Kjo nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë para, pasi ajo është e varur nga sasia e energjisë elektrike së prodhuar nga hidrocentrali. Një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit në një marrëveshje koncesionare shërbimi fillimisht matet me kosto.

(ii) Kostot vijuese

Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me kosto të amortizuar, e cila përfshin kostot e kapitalizuara të huamarrjes, minus amortizimin dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

(iii) Amortizimi

Jeta e dobishme e pritshme e një aktivi jo-material në një marrëveshje koncesionare të shërbimeve është periudha nga momenti kur Shoqëria është në gjendje të përdorë infrastrukturën deri në fund të periudhës së koncesionit. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare dhe njihet si fitim ose humbje. Jeta e dobishme e vlerësuar e koncesionit me datë 31 dhjetor 2014 është 29 vjet.

(c) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata të materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse përfshihet), çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërsëdrejti me përgatitjen e aktiveve për gjendje pune, për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e terrenit ku ato ndodhen në gjendjen fillestare, dhe kostot e huamarrjes që lidhen me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve përkatëse. Shpenzimet kapitale të ndodhura gjatë ndërtimit të aktivitet, janë kapitalizuar në "aktive në proces" dhe transferohen në kategorinë e aktivitet përkatës, kur ndërtimi të përfundojë. Aktivi do të amortizohet në bazë të kategorisë që do të klasifikohet.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si pjesë të veçanta (përbërës kryesore) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një objekti të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur, dhe janë të njohura si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve të vazhdueshme të aktiveve afatgjata njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

c) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve materiale përllogaritet duke përdorur metodën lineare, për periudhë aktuale dhe krahasuese, me norma si më poshtë :

	2023: Ne %	2022: Ne %
• Aktive të tjera të materiale	20%-25%	20%-25%

Jetët e dobishme, metodat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse nuk janë jodomethënëse, rivlerësohen në datën e raportimit. Toka dhe aktivet në proces nuk zhvlerësohen.

(d) Inventari

Inventari vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të aktivitetit të biznesit minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto e inventarit përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit dhe kosto të tjera të ndodhura me qëllim sjelljen e inventarit në gjendjen dhe vendndodhjen aktuale.

(e) Instrumentet financiare

Aktivitet Financiare klasifikohen në njohjen fillestar dhe maten me vone me kosto të amortizueshme, me vlerë të drejtë nepermjet të ardhurat gjithëpërfshirëse (OCI), dhe me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes. Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arketueshme dhe depozitat monetare në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e percaktuara me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria behet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin prej aktivitet përfundojnë, ose ajo i transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale nga aktiviteti financiar nëpërmjet një transaksioni, ku në mënyrë thelbësore gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar transferohen. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen, ose përfundojnë.

Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose detyrim i vecantë. Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumën dhe synon ose të shlyejë mbi bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Instrumentet financiare jo-derivative të shoqërisë përfshijnë llogaritë e kërkesa të arketueshme, mjetet monetare dhe depozitat, huatë, furnitoret dhe detyrime të tjera.

Mjete monetare, ekuivalentet me to dhe depozitat

Mjetet monetare, ekuivalentet me to përfshijnë llogaritë rrjedhëse në bankë, investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet origjinal tre muaj ose më pak dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizuar në bilancin kontabël.

Llogaritë të arketueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektive, duke zbritur provigjonet për zhvlerësim.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Instrumentet financiare (vazhdim)

Huatë

Huatë maten fillimisht me vlerën e drejte, neto për kostot e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metoden e interesit efektiv, nderkohe që shpenzimet e interesit njihen me normën efektive të interesit. Metoda e interesit efektiv është një metode e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e regjistrimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës perkatese. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e ardhshme monetare të vlerësuar gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, kur është e përshtatshme, gjatë një periudhe më të shkurtër.

Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

Pas njohjes fillestare llogaritë të pagueshme tregtare dhe të tjera njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metoden e interesit efektiv.

(f) Zhvleresimet

Aktivitet financiar

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka një evidence objektive se ai është zhvlerësuar. Shoqëria njihë një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen në diferencën ndërmjet flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhet në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukse monetare që Shoqëria pret të marrë, të skontuara me një përafrim të normës fillestare të interesit efektiv. Flukset monetare priten të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose të ardhura të tjera që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës kontabel dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen në një llogarë zhvlerësimi përkundërt llogaritës të arkëtueshme. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nepermjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pasuese ndikon në uljen e shumës së zhvlerësimit, renia në humbjen nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Për të llogaritë të arkëtueshmet tregtare, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e ECLs. Si rrjedhojë, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njihë një humbje nga zhvlerësimi të bazuar në jetëgjatësinë e ECL-ve në çdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë provizionesh që bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve nga kreditimi, të përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifike për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

Aktivitet jo-financiar

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka evidence për zhvlerësim. Nëse ka evidence të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është me e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe rreziqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabel e një aktivi ose e njësive gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje).

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret kur ka tregues se zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka ndodhur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të caktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në masën që vlera e mbetur e aktivitetit, nuk tejkalon vlerën kontabel, neto nga amortizimi, në rast se nuk do ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar perbehet prej mjeteve monetare te kontribuara nga themeluesit e shoqerise. Kapitali aksionar mbahet ne shumen e konvertuar leke te monedhes se huaj te marre, duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

(h) Provigjionet për risqe

Një provigjion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një dalje e flukseve të të mirave ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimit. Provigjionet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

(i) Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore të pronësisë janë transferuar tek blerësi, marrja e kompensimit është e mundur, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të mëtejshme të drejtimit në energjinë e shitur, si dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten neto nga kthimet, zbritjet tregtare si dhe kompensimet e vëllimit. Për shitjen e energjisë elektrike, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë është injektuar në rrjetin e transmetimit dhe është matur në pikën e furnizimit. Kompensimet e marra dhe të paguara bazuar në Marrëveshjen 'Off-Take' me FTL njihen siç përshkruhen në shënimin 1.

(j) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Shoqeria kryen vetem kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që ofrojnë punonjësve perfitime pas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për percaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të percaktuar. Kontributet e shoqërisë ndaj planit të pensioneve janë ngarkuar në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(k) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ndodhin.

(l) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara. Të ardhurat nga interesat njihen ndërsa përlllogariten në pasqyrën e të ardhurave, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga veprimet në monedhë të huaj raportohen në baza neto.

(m) Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e rikuperueshme e tatimeve mbi të ardhurat në lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme për një periudhë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm të viteve të mëparshme.

Tatimi aktual mbi të ardhurat llogaritet në masën 15 % (2023: 15%) mbi fitimin e tatueshëm.

Tatimi i shtyrë është llogaritur në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në datën e raportimit.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra janë rishikuar në çdo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitimi fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse ka detyrime të tjera për taksa dhe interesa. Shoqëria beson se përlllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë edhe interpretimet e ligjit të taksave dhe përvojës së mëparshme. Kjo llogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

(n) Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është shumë e ulët. Një aktiv i kushtezuar nuk njihet në pasqyrat financiare por është pasqyruar në shenimet shpjeguese kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes së kushtezuar është njohur si provigjon nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmohen dhe se mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes në datën e pozicionit financiar.

(o) Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura janë ato ku njëra nga palet është e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palet tjetër.

(p) Ngjarjet pas periudhës së raportimit

Ngjarjet pas perfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e shoqërisë në datën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas perfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë pasqyruar në shenime kur janë materiale.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar nga rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i tregut
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i kredisë

Ky shënim përfaqëson informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat e matjes dhe menaxhimit të rrezikut dhe menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë. Shënime të tjera shpjeguese sasiore janë të përfshira përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballë, për të vendosur limite dhe kontrole, dhe monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin çdo punonjës kupton rolin dhe detyrimet përkatëse.

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rrjedhojë e ndryshimeve në çmimet e tregut, në kurset e këmbimit të valutës, në normat e interesit dhe në çmimet e kapitalit.

Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Shoqëria, në një moment të caktuar kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të pritshmërive të çmimeve të ardhshme apo lëvizjeve në normat e tregut, të përbërjes së aktiveve fizike të Shoqërisë dhe marrëveshjeve në të cilat Shoqëria është angazhuar. Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të jetë i pranueshëm, i cili monitorohet çdo muaj. Gjithsesi, kjo qasje nuk parandalon humbjet përtej këtyre limiteve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë kryhet në monedhat Lek dhe Euro. Rreziku i kursit të këmbimit krijohet kur transaksione të ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Duke qenë se huatë janë marrë në Euro, dhe aktiviteti kryhet në Lek, ekziston rreziku i mospërputhjes së monedhave të huaja. Meqë monedha raportuese është Lek, drejtimi vlerëson se rreziku i monedhës së huaj mund të përbëjë një problem për Shoqërinë. Shoqëria arketon të ardhurat në të njëjtën monedhë si borxhi i pagueshem dhe për këtë arsye zvogëlon rrezikun e humbeve nga kurset e këmbimit.

Pozicionet monitorohen çdo muaj. Kurset e këmbimit të mëposhtme, janë aplikuar gjatë periudhës:

	Kursi mesatar		Kursi i këmbimit në datën e raportimit	
	2024	2023	2024	2023
Lek / EUR	100.71	108.75	98.15	103.88

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2024	Euro	Lek	Totali
(shumat janë të perkthyer në Lek)			
Aktivët financiarë			
Mjetet monetare	170,664,871	5,671,713	176,336,584
Llogari të arketueshme	282,778,530	-	282,778,530
Depozita dhe mjete monetare të kufizuara	-	5,168,539	5,168,539
Aktive të tjera	1,893,105,385	114,039,817	2,007,145,202
	2,346,548,786	124,880,069	2,471,428,855
Detyrimet financiare			
Te pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrime të tjera	90,829,186	50,567,700	141,396,886
Hua	7,210,862,246	-	7,210,862,246
	7,301,691,432	50,567,700	7,352,259,132
Ekspozimi neto 31 dhjetor 2024	(4,955,142,646)	74,312,369	(4,880,830,277)

31 dhjetor 2023	Euro	Lek	Totali
(shumat janë të perkthyer në Lek)			
Aktivët financiarë			
Mjetet monetare	3,669,264	2,410,957	6,080,221
Llogari të arketueshme	521,614,149	-	521,614,149
Depozita dhe mjete monetare të kufizuara	-	3,010,750	3,010,750
Aktive të tjera	1,579,014,548	62,347,567	1,641,362,115
	2,104,297,961	67,769,274	2,172,067,235
Detyrimet financiare			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9,665,479	241,933,774	251,599,253
Hua	8,360,832,616	-	8,360,832,616
	8,370,498,095	241,933,774	8,612,431,869
Ekspozimi neto 31 dhjetor 2023	(6,266,200,134)	(174,164,500)	(6,440,364,634)

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

Duke menaxhuar rrezikun e kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në afatgjatë, megjithatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit të monedhës së huaj mund të kenë një ndikim në fitim. Një vlerësim ose zhvlerësim i Lekut, siç paraqitet më poshtë, mund të ketë ndikimet përkatëse në ulje ose rritje të kapitalit dhe të fitimit ose humbjes me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë bazohet në variancat prej 10% të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja, që Shoqëria konsideron në mënyrë të arsyeshme të mundshme në fund të periudhës raportuese.

<i>Ne Lek</i>	31 dhjetor 24		31 dhjetor 23	
	Rritje	Renie	Rritje	Renie
EUR	(495,514,264)	495,514,264	(626,620,013)	626,620,013

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(ii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku kyresor ndaj të cilit portfolet jo të tregtueshme janë ekspozuar janë rreziqet nga luhatja e flukseve të ardhshme monetare ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë për shkak të ndryshimit të normës së interesit të tregut. Shoqëria ka dy hua afatgjata, norma e interesit e të cilave është fikse, prandaj një ndryshim në normat e interesit në treg nuk do të ndikonte në kapitalin dhe fitimin/ (humbjen) e shoqërisë para takses.

(a) Rreziku i tregut (vazhdim)

(iii) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të ruajë një bazë të fortë kapitali, në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitoreve, kreditorëve dhe tregut dhe për të ruajtur zhvillimet e ardhshme të biznesit. Nuk ka patur ndryshime në metodën e menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë gjatë vitit.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kur ato janë të pagueshme. Shoqëria është e ekspozuar çdo ditë ndaj kërkesës për burimet e saj monetare kryesisht për të shlyer shpenzimet operative që kryhen gjatë aktivitetit të zakonshëm të saj dhe për të shlyer keqet e dy huave afatgjata.

Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurohet, sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë gjithmonë likuiditetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e saj në afat, si në kushte normale dhe në ato të rënda, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e imazhit të Shoqërisë. Shoqëria pret të përmbushë detyrimet përmes flukseve të pritshme të parasë nga aktiviteti i saj operacional.

Tabela e mëposhtme tregon flukset e aktualizuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke marrë për bazë maturitetin më të hershëm kontraktual ose flukset e pritshme.

31 dhjetor 2024	Deri në 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Te pagueshme ndaj furnitoreve	70,358,942	-	71,037,944	141,396,886
Hua	193,137,246	515,287,500	6,502,437,500	7,210,862,246
Totali i detyrimeve financiare	263,496,188	515,287,500	6,573,475,444	7,352,259,132

31 dhjetor 2023	Deri në 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Te pagueshme ndaj furnitoreve	205,604,275	-	45,994,978	251,599,253
Hua	206,252,615	545,370,000	7,609,210,000	8,360,832,616
Totali i detyrimeve financiare	653,790,664	545,370,000	7,655,204,978	8,612,431,869

(c) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij kontraktual që lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë dhe nga mjetet monetare të mbajtura në banka.

Kufijte individuale të ekspozimit të secilës pale monitorohen vazhdimisht dhe raportohen rregullisht tek manaxhimi. Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë nga të arketueshmet tregtare duke caktuar një periudhë pagese prej një muaji.

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi maksimal i Shoqerise më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

Klasat e aktiveve financiare – vlerat e mbartura:	2024	2023
Mjetet monetare	176,336,584	6,080,221
Depozita dhe mjete monetare te kufizuara	5,168,539	3,010,750
Aktive te tjera	2,007,145,202	1,641,362,115
Llogari te arketueshme	282,778,530	521,614,149
Totali	2,471,428,855	2,172,067,235

(c) Rreziku i kredise (vazhdim)

Drejtimi pret të arkëtojë të gjithë të arkëtueshmet gjendje në fund të vitit. Të arkëtueshmet janë kryesisht detyrime nga partnerët kontraktualë. Kërkesat e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 sipas vjetërsisë janë detajuar si më poshtë:

	2024	%	2023	%
Më pak se 1 muaj	-	0%	-	0%
1 deri në 3 muaj	282,778,530	100.00%	521,614,149	100.00%
Mbi 3 muaj	-	0%	-	0%
Totali	282,778,530	100.00%	521,614,149	100.00%

6. VLERA E DREJTE

Vlera e drejte perfaqeson vleren me te cilen nje aktiv mund te zevendesohet ose nje detyrim te shlyhet ne kushte te tregut. Vlera e drejte eshte bazuar ne suozimin e drejtimit ne perputhje me profilin e aktivitetit dhe bazen e detyrimit.

(i) Instrumentet financiare te paraqitura me vleren e drejte

Aktivet financiare te matura me vleren e drejte jane ne perputhje me hierarkine e vleres se drejte e cila i grupon aktivet dhe detyrimet financiare ne tre nivele bazuar ne rendesine e te dhenave te perdorura gjate matjes se vleres se drejte te aktiveve financiare. Hierarkia e vleres se drejte eshte si vijon:

- **Niveli 1:** cmimet e kuotuar (te pakorrigjuara) ne tregjet aktive per aktive ose detyrime financiare te ngjashme;
- **Niveli 2:** te dhena te tjera pervec cmimeve te kuotuar per perfshira ne Nivelin1 qe jane te disponueshme per aktivet dhe detyrimet te obsevuara, direkt (psh cmimet) ose indirekt (te dhena nga cmimet) dhe
- **Niveli 3:** te dhena mbi aktivet dhe detyrimet qe nuk jane bazuar ne te dhena te disponueshme nga observimi itregut.

Me 31 dhjetor 2024 dhe 2023, vlera e aktiveve dhe detyrimeve financiare te Shoqerise ne perputhje me klasifikimin e tyre eshte percaktuar duke perdorur koston e amortizuar.

(ii) Instrumentet financiare te cilat nuk jane prezantuar me vleren e drejte

Me poshte paraqitet ne krahasim sipas klasave, i vlerave te mbartura dhe vlerave te drejta te instrumentave financiare te Shoqerise sic jane pasqyruar ne pasqyrat financiare.

	Vlera e mbarur		Vlera e drejte	
	2024	2023	2024	2023
Llogari dhe kerkesa te arketueshme	2,289,923,732	2,162,976,264	2,289,923,732	2,162,976,264
Depozita dhe mjete monetare te kufizuara	5,168,539	3,010,750	5,168,539	3,010,750
Mjete monetare	176,336,584	6,080,221	176,336,584	6,080,221
Totali i aktiveve	2,471,428,855	2,172,067,235	2,471,428,855	2,172,067,235
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	141,396,886	251,599,253	141,396,886	251,599,253
Hua	7,210,862,246	8,360,832,616	7,210,862,246	8,360,832,616
Totali i detyrimeve	7,352,259,132	8,612,431,869	7,352,259,132	8,612,431,869

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

6. VLERE E DREJTE (VAZHDIM)*Llogari dhe kërkesa të tjera të arketueshme*

Llogaritë dhe kërkesa të tjera të arketueshme mbahen me kosto të amortizuara, minus provigjonet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejte korrespondon me vlerën e tyre të mbartur si rezultat i natyrës së tyre afatshkurter.

Mjetet monetare

Vlera e drejte e mjeteve monetare konsiderohet e përafërt me vlerën e tyre të mbartur si rezultat i maturimit të tyre të hkurter.

Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera

Vlera e mbartur e llogarive të pagueshme dhe kredive të pagueshme përafërt me vlerën e tyre të drejte.

(iii) Instrumenta financiare sipas kategorise

Vlerat kontabel të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë sic paraqiten në datën e pasqyrës së pozicionit financiar për periudhat raportuese mund të kategorizohen si vijon.

	Instrumente borxhi me kosto të amortizuar	Aktive me vlerë të drejte nepermjet fitimit ose humbjes	Instrumente borxhi/Aktive me vlerë të drejte nepermjet OCI	Totali
31 dhjetor 2024				
Llogari dhe kërkesa të arketueshme	2,289,923,732	-	-	2,289,923,732
Depozita dhe mjete monetare të kufizuara	5,168,539	-	-	5,168,539
Mjete monetare	176,336,584	-	-	176,336,584
	2,471,428,855	-	-	2,471,428,855
	Detyrimet financiare me vlerë të drejte nepermjet fitimit ose humbjes		Detyrimet financiare me kosto të amortizuar	Totali
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera		-	141,396,365	141,396,365
Hua		-	7,210,862,246	7,210,862,246
		-	7,352,258,611	7,352,258,611

	Instrumente borxhi me kosto të amortizuar	Aktive me vlerë të drejte nepermjet fitimit ose humbjes	Instrumente borxhi/Aktive me vlerë të drejte nepermjet OCI	Totali
31 dhjetor 2023				
Llogari dhe kërkesa të arketueshme	2,162,976,264	-	-	2,162,976,264
Depozita dhe mjete monetare të kufizuara	3,010,750	-	-	3,010,750
Mjete monetare	6,080,221	-	-	6,080,221
	2,172,067,235	-	-	2,172,067,235

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Detyrimet financiare me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes	Detyrimet financiare me kosto te amortizuar	Totali
Detyrime sipas pasqyres se pozicionit financiar			
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	-	251,599,253	251,599,253
Hua	-	8,360,832,616	8,360,832,616
	-	8,612,431,869	8,612,431,869

Energji Ashta Sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Objektet e rrjetit	Mjete transporti	Paisje zyre	Paisje IT	Total
Kosto					
Më 1 Janar 2023	-	63,290,084	31,654,159	6,698,119	101,642,362
Shtesa	-	-	-	124,178	124,178
Pakësime	-	(1,500,000)	-	-	(1,500,000)
Më 31 Dhjetor 2023	-	61,790,084	31,654,159	6,822,297	100,266,540
Shtesa	-	6,352,146	850,219	-	7,202,365
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	-	68,142,230	32,504,378	6,822,297	107,468,905
Amortizimi dhe zhvlerësimi I akumuluar					
Më 1 Janar 2023	-	(47,959,905)	(26,395,527)	(1,937,356)	(76,292,788)
Pakësime	-	1,308,628	-	-	1,308,628
Shpenzim amortizimi I vitit	-	(2,983,635)	(1,184,521)	(1,081,919)	(5,250,075)
Më 31 Dhjetor 2023	-	(49,634,911)	(27,580,048)	(3,019,275)	(80,234,235)
Pakësime	-	-	-	-	-
Shpenzim amortizimi i vitit	-	(1,879,944)	(3,253,960)	(37,396)	(5,171,300)
Më 31 Dhjetor 2024	-	(51,514,855)	(30,834,007)	(3,056,671)	(85,405,535)
Vlera e mbartur					
Më 1 janar 2023	-	15,330,179	5,258,632	4,760,763	25,349,574
Më 31 dhjetor 2023	-	12,155,173	4,074,111	3,803,022	20,032,305
Më 31 dhjetor 2024	-	16,627,375	1,670,371	3,765,626	22,063,370

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe))

8. AKTIVE JO-MATERIALE

	Total
Kosto	
Më 1 janar 2023	30,302,466,251
Pakesime	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2023	30,302,466,251
Pakesime	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2024	30,302,466,251
Amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar	
Më 1 janar 2023	(14,146,358,638)
Shpenzim amortizimi i vitit	(775,648,780)
Amortizimi i aktiveve te nxjerra nga perdorimi	-
Më 31 dhjetor 2023	(14,992,007,418)
Shpenzim amortizimi i vitit	(775,831,794)
Amortizimi i aktiveve te nxjerra nga perdorimi	-
Më 31 dhjetor 2024	(15,697,839,212)
Vlera e mbartur	
Më 1 janar 2023	16,156,107,613
Më 31 dhjetor 2023	15,380,458,833
Më 31 dhjetor 2024	14,604,627,039

Ne vitet e mëparshme, ulja e pritshmërisë për Energji Ashta Shpk në lidhje me të ardhurat nga shitja e certifikatave për pakësim ndotjesh (CER) ishin tregues të zhvlerësimit, siç ishin dhe shpenzimet për investime dhe rreziku i vendit me ndikim në normën e skontimit, Më 31 dhjetor 2013, humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi për aktivet afatgjata ishin 5,919,292,889 Lek, Në vijim të testit të zhvlerësimit të kryera në vitin 2015, nuk është identifikuar zhvlerësim i mëtejshëm,

Përcaktimi i vlerës në përdorim u bazua mbi një nivel konstant prodhimi gjatë periudhës së planifikimit që korrespondon me kapacitetin mesatar të energjisë. Periudha e planifikimit përfshiu afatin e pritshëm të koncesionit të hidrocentralit. Vlera në përdorim u përcaktua me metodën e skontimit të flukseve të ardhshme të parasë (DCF) me normë skontimi para tatimit për periudhën e planifikimit nga 8.25% në 9.0% në vit,

Supozimet kryesore për vlerësimin mbi të cilat u mbështet përcaktimi i shumës së rikuperueshme, përfshijnë çmimet e parashikuara të energjisë për periudhën pas përfundimit të marrëveshjes për blerjen e energjisë me FTL (shënimi 1) dhe normën e skontimit, Çmimet për 15 vitet e para pas komisionimit u përcaktuan në bazë të marrëveshjes së blerjes të energjisë elektrike me FTL, ndërsa çmimet e energjisë elektrike për vitet më pas u përcaktuan në bazë të një modeli të brendshëm të tregut të energjisë,

Me date 31 dhjetor 2024 dhe me 31 dhjetor 2023 drejtimi i Shoqërisë konkludoi se nuk u identifikua zhvlerësim tjetër.

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

9. INVENTARI

Inventari përbëhen nga pjesë ndërrimi të ndryshme dhe materiale konsumi që janë të nevojshme për mirëmbajtjen e Hidrocentralit.

Inventari përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Vajra dhe lubrifikantë	411,240	276,886
Kimikate	952,172	1,062,129
Materiale elektrike dhe pjesë këmbimi elektrike	74,387,202	73,554,113
Pjese ndërrimi dhe materiale metalike	44,789,879	44,729,584
Total	120,540,493	119,622,712

10. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Parapagimet ndahen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagimet e tarifave të ngarkuara nga Palet e Lidhura	5,991,239	6,946,975
Total	5,991,239	6,946,975

11. LLOGARI TË ARKETUESHME

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogri te arketueshme	282,778,530	521,614,149
Total	282,778,530	521,614,149

Llogarite e arketueshme perbehen nga Shoqeria FTL qe eshte klienti i vetem qe blen energjine e prodhuar. Shoqeria FTL ka pajisur Shoqerine me nje Leter Garancie leshuar nga Banka CREDINS ne Shumen 3.71 milion Euro me vlefshmeri deri me 23.09.2025 e lidhur me detyrimet e Bleresit bazuar në marrëveshjen 'Off-Take'.

12. AKTIVE TË TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime për tatim fitimin	114,039,817	62,279,767
Te drejta nga palet e lidhura	1,893,056,997	1,579,019,348
Parapagime punonjes	48,383	67,800
Totali	2,007,145,202	1,641,362,115

Te drejta nga palet e lidhura paraqesin tepricën e një llogarie me VERBUND Finanzierungsservice GmbH. Kjo llogari përdoret për të mbledhur ose shlyer pagesat me palët e treta ose palët e lidhura, dhe për të marrë fonde nga pronarët. Keto balance jane te shprehura ne EUR.Interesi ne gjendjen e llogarise rritet me normen e aplikueshme te interesit e cila eshte brenda parimit te tregut.Nje norme e tille interesi percaktohet ne baze te direktives se grupit te VERBUND -grupi ne versionin aktual te tij dhe do te informoje Energji Ashten per cdo ndryshim te kesaj direktive te grupit.Interesi llogaritet ne baze te numrit te diteve te kaluara dhe nje

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

12. AKTIVE TË TJERA (VAZHDIM)

viti prej 360 ditësh (akt/360) dhe do të paguhet në fund të çdo periudhe interesi (aktualisht një muaj kalendarik).

Parapagimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave përfaqësojnë pagesa për tatimin mbi të ardhura të bera gjatë viteve të mëparshme 2018-2019, periudha kur Shoqëria nuk rezultoi me fitim të tatueshëm për shkak të çështjeve të hapura gjyqësore, kjo shumë e parapagimeve nuk është marrë në konsideratë si ulje e tatimit mbi të ardhura të vitit 2022 sepse kjo shumë përdoret si zbritje e detyrimeve të vlerësimit tatimor të bërë nga organet tatimore, vlerësimi nr.1854/12 datë 01.12.2022.

13. DEPOZITA DHE MJETE MONETARE TË KUFIZUARA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozite e bllokuar si garanci për Drejtorinë e Tatimpaguesve të Medhenj	2,168,539	-
Interes i përlllogaritur	-	10,750
Deposite	3,000,000	3,000,000
Total	5,168,539	3,010,750

Me datë 23.05.2022, janë lëshuar dy Letra Graanci nga Raiffeisen Bank në vlerat 1.6 Mil Euro e vlefshme deri më 04.07.2023 dhe 4.8 Mil Euro e vlefshme deri më 04.07.2025, si garanci për Ministrinë e Energjitikës dhe Infrastruktura.

Për të dhënë Raiffeisen Bank garancinë e duhur, si EVN AG ashtu dhe VERBUND AG, pale të lidhura të kompanisë, kanë lëshuar Garanci Korporative ndaj bankës në shumën prej 3.2 milion Euro secila.

Gjatë Vitit 2018 Shoqëria i është nënshtruar kontrollit tatimor për periudhën 2012-2016 tatim fitimi si dhe për periudhën Prill 2014-Qershor 2017 për tatimet taksa e të tjera. Garancia bankare në vlerën 2,168,539 Lek më 31.12.2022 përbehet nga shumata të mbajtura në Raiffeisen Bank Albania në favor të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Medhenj, në funksion të procesit të ankimit tatimor në të cilin është përfshirë Shoqëria.

14. MJETE MONETARE

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari rrjedhëse		
Në Lek	5,671,713	2,410,957
Në Euro	170,664,871	3,669,264
Totali	176,336,584	6,080,221

15. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i paguar është i regjistruar në Lek, Energji Ashta Sh.p.k, fillimisht ishte në pronësi të Verbund-International GmbH, Disa transferime pasuese të kapitalit aksionar u bazuan në marrëveshjet e blerjes së aksioneve si më poshtë:

- 20 prill 2010: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga VERBUND-International GmbH tek EVN AG;
- 13 janar 2011: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga VERBUND-International GmbH tek VERBUND Hydro Power GmbH;
- 6 shtator 2011: VERBUND Hydro Power GmbH dhe EVN AG transferuan 100% të aksioneve tek Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH, ndërkohë që kjo e fundit mbetet në pronësi të këtyre dy shoqërive;

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

15. KAPITALI AKSIONAR (VAZHDIM)

- 20 tetor 2015: Bazuar në vendimin e aksionarit, kapitali aksionar i Shoqërisë u rrit nëpërmjet kontributit në para në shumën 1,677,720,000 Lek,

Struktura e pronësisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Total në Lek	%	Total në Lek	%
Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH	12,460,176,500	100	12,460,176,500	100

16. HUATË AFATGJATA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
VERBUND AG	3,605,431,123	4,180,416,308
Raiffeisen Bank International	3,605,431,123	4,180,416,308
Totali	7,210,862,246	8,360,832,616
Detyrimi afatshkurtër	708,424,746	751,622,616
Detyrimi afatgjatë	6,502,437,500	7,609,210,000

Huatë janë marrë nga palet e meposhtme;

Me date 15.11.2019 VERBUND AG dhe Raiffesien Bank International AG disbursuan dy hua për Shoqërinë nga 6 milion Euro secila, si terheqja e parë e një linje kredie prej 46,25 milion Euro. Terheqja e dytë është disbursuar më 19.04.2022 në vlerën 40,25 milion Euro. Këto kredi janë përdorur për rifinancimin e kredive nga viti 2013. Kushtet e kredive përfshijnë një normë interesi fikse prej 1.39% p.a, me shlyerje tërheqje duke filluar nga prill 2022 me periudhë kreditimi deri në Tetor 2029.

Huamarrja është garantuar nga aksionarët e Shoqërisë, dhe për këto garanci ata i ngarkojnë Shoqërisë, një tarifë prej 2% mbi shumën e papaguar.

17. LLOGARITE E PAGUESHME DHE DETYRIME TË TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime të përlllogaritura	84,621,707	80,929,085
Detyrime të tatimit fitim	-	118,930,436
TVSH e pagueshme	46,332,131	50,446,272
Detyrime të tjera ndaj furnitorëve	7,924,982	125,579
Sigurime shoqërore	862,111	787,381
Tatim mbi të ardhurat personale	458,748	380,500
Detyrime dhe taksa të tjera	1,197,205	-
Totali	141,396,886	251,599,253

18. TË ARDHURAT

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Shitja e energjisë	1,790,177,455	2,275,124,640
Te Ardhura të tjera	523,376	58,185
Totali	1,790,700,831	2,275,182,825

Te ardhurat nga shitja e energjisë rrjedhin nga Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike. Te ardhurat për dy licensat e tjera, ato të Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike dhe Tregtimit të Energjisë Elektrike janë zero.

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

19. KOSTOT E PERSONELIT

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Paga dhe shpërblime	51,082,185	47,902,020
Sigurime shoqërore	6,156,440	5,725,074
Shpenzime të tjera të personelit	1,454,880	1,605,110
Totali	58,693,505	55,232,204

Shpenzime të tjera të personelit kanë të bëjnë me kontribute vullnetare shëndetësore. Në 31 dhjetor 2024, Shoqëria kishte punësuar 21 punonjës (2023: 21)

20. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative përbehen si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Shërbime profesionale konsulence	24,961,228	34,979,360
Mirëmbajtje dhe riparime	34,949,698	28,451,669
Shpensime për sigurime	15,325,113	16,738,350
Taksa dhe tarifa të tjera	8,680,379	6,733,951
Shpenzime për IT	6,027,412	5,703,298
Shpenzime për automjetet	4,296,143	3,866,072
Shpenzime postare dhe telefoni	3,111,897	2,729,346
Materiale zyre	3,121,929	2,648,392
Shpenzime auditimi	946,200	938,780
Shpenzime transporti	2,774,817	1,408,398
Shpenzime për trajnime	1,907,084	1,510,150
Shpenzime sponsorizimi	195,290	261,700
Shpenzime për udhetime e dieta	1,068,518	2,874,417
Shpenzime për mjekim	935,980	673,883
Komisione bankare	297,040	128,759
Shpenzime përfaqësimi	868,145	1,399,537
Shpenzime qiraje	-	250,765
Gjoka dhe penalitete	282,319	43,933
Shërbime për sigurime	5,645,924	6,069,351
Të tjera	5,040,456	4,165,773
Totali	120,435,572	121,575,885

21. INTERESI DHE TARIFA TË TJERA

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Shpenzime interesi për huane (VERBUND AG)	140,268,550	165,995,659
Shpenzime interesi për huane (Raiffeisen Bank International)	140,268,549	165,995,659
Total	280,537,099	331,991,318

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

22. FITIMI/(HUMBJA) NETO NGA KURSET E KEMBIMIT

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Te ardhurat nga rivleresimi (data e raportimit)	(3,600,000)	14,597,470
Te ardhurat nga kurset e kembimit (data pageses se huasë)	141,302,094	82,535,640
Te ardhurat nga kurset e kembimit (realizimi)	180,617,215	8,061,330
Te ardhurat nga kurset e kembimit	318,319,309	105,194,440
Humbja nga rivleresimi (data e raportimit)	194,045,859	652,894,516
Humbja nga kurset e kembimit (realizimi)	(189,771,124)	(45,522,426)
Humbjet nga kurset e kembimit	4,274,734	607,372,090
Te ardhurat/(humbja) nga kurset e kembimit, neto	322,594,044	712,566,530

23. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria përcakton tatimin ne fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, Në vitin 2024, norma e tatim fitimit në Shqipëri ishte 15%, (2023:15%), Më poshtë paraqitet rakordimi i tatim fitimit të përllogaritur me normat përkatëse me shpenzimin e tatimit:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
Fitim/(humbje) para tatim fitimit	891,440,358	1,683,700,217
Total shpenzimet e pazbritshme	2,649,665	2,696,559
Shpenzime transporti	1,303,911	991,389
Sponsorizime	195,290	261,700
Shpenzime perfaqesimi	868,145	1,399,537
Gjoha dhe penalitete	282,319	43,933
Cdo lloj shpenzimi, the vlere qe nuk suportohet me nje dokument		
Shtese amortizimi tatimor	(192,821,545)	(193,004,560)
Ndryshime ne provigjione	3,692,622	(2,011,918)
Humbjet tatimore të mbartura		
Tatimi mbi fitimin prej 15% (2022: 15%)	105,744,165	223,707,045

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 dhe 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	105,744,165	223,707,045
Shpenzimi tatimor i shtyrë	28,923,753	28,950,683
Total	134,667,918	252,657,728

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

23. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Aseti tatimor i shtyrë i njohur i atribuohet zërave të mëposhtëm:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivi jomaterial		
Bilanci	14,604,627,039	15,380,458,832
Baza tatimore	18,242,971,228	19,211,624,567
Diferencë e përkohëshme	3,638,344,188	3,831,165,734
Aseti tatimor I shtyre (me norme tatimore 15%)	545,751,628	574,674,860

24. ANGAZHIME DHE KUSHTËZIME

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale te nenkontraktuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar te cilat te mos jene reflektuar ne pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe te dhenat kontabel per vitet financiare qe perfundojne me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 nuk jane audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim detyrimet tatimore te Shoqërisë mund te mos konsiderohen te finalizuara.

Çeshtje Gjyqesore

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendime te ndryshme ligjore dhe gjyqësore.

Per vitin ushtrimor 2022, Shoqëria ka krijuar provigjon per detyrimet tatimore te ngritura nga kontrolli tatimor i viteve 2019 dhe 2020 , dhe ky kontroll tatimor eshte kundertshtuar nga shoqëria me ane te nje procesi gjyqesor.

Menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit nuk do te shkaktohen humbje te tjera materiale nga kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2024.

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrë financim nga palët e lidhura dhe garanci prej tyre për huatë që ka marrë (shih shënimet 10 dhe 14), Shpenzimet e paguara për palët e lidhura ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive		
VERBUND Finanzierungsservice GmbH	1,893,056,996	1,579,019,348
	1,893,056,996	1,579,019,348
Detyrime		
VERBUND AG	3,605,431,123	4,180,416,308
Total	3,605,431,123	4,180,416,308
 Shpenzime operative		
VERBUND Hydro Power GmbH	5,762,728	6,514,793
VERBUND Services GmbH	7,108,869	16,964,928
VERBUND Finanzierungsservice GmbH	217,745	248,484
Total	13,089,342	23,728,205

Energji Ashta Sh.p.k.

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

*(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)***25. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA (VAZHDIM)**

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023
<i>Kostot e financimit</i>		
VERBUND AG	61,308,960	73,342,532
EVN AG	82,604,786	98,741,323
VERBUND Hydro Power GmbH	77,897,718	91,701,105
Total	221,811,464	263,784,960

26. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka pasur ndonjë ngjarje pasuese domethënëse pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullim ose shpjegim në këto pasqyra financiare.